

KADAREJA ANGLISHT

[V.M.]: *Në një gazetë tiranase është shkruar koha e fundit se ju jeni shprehur për çmimin që i është dhënë shkrimtarit tonë së fundi në Britani se "Kadare është pak i njohur dhe pak i përkthyer në gjuhën angleze". Pohimin tuaj gazeta në fjalë e ka cilësuar si të pavërtetë dhe të papranueshëm për një personalitet si ju. Nëse ju e pranoni pohimin e mësipërm, nga jeni nisur për të shprehur një konkluzion të tillë për botimin e veprave të Kadaresë në Britani?*

[R.E.]: Duhet të ju them se jam habitur pak nga ky artikulli. Nuk jam shprehur fare deri tani për çmimin Man Booker Ndërkombëtar i cili i është akorduar Zotit Kadare dhe për të cilin e përgëzoj për zemërsisht. Nga ana tjetër, është e vërtetë që kam thënë se Kadareja është relativisht pak i njohur dhe pak i përkthyer në gjuhën angleze. Këtë pohim e bëra, besoj, në një ligjeratë që i kushtova Kadaresë në janar të këtij viti në Amerikë, kur isha ftuar nga Universiteti i Miçiganit. Besoj se gazeta në fjalë e ka keqkuptuar apo keqinterpretuar diçka. Pohimi nuk është aspak denigrues për Zotin Kadare, është vetëm një realitet, që me siguri edhe autori e pranon. Sipas llogaritjes sime së përafërt, deri tani 35 vepra të Kadaresë kanë dalë në gjuhën frënge, 24 kanë dalë në gjuhën greke dhe 23 kanë dalë në gjuhën spanjolle, kurse vetëm 12 kanë dalë në gjuhën botërore, anglishtja! Kur i krahasojmë 12 vëllimet anglisht mëtej, për shembull me 20 vëllimet që kanë dalë hollandisht, pra në një gjuhë të vogël, besoj se del e qartë që vepra letrare e Kadaresë nuk ka depërtuar në atë masë në botën anglishtfolëse si në vendet e tjera. Kadareja është një emër i njohur për lexuesin francez dhe librat e tij shiten shumë, kurse në Amerikë apo në Angli zor të gjesh një libër të Kadaresë në një libreri. Tregu është i ndryshëm.

Shihet pra që ka shumë për t'u bërë në mënyrë që veprat e tij të njihen më mirë në vendet anglishtfolëse. Unë jam i bindur që akordimi i çmimit Man Booker Ndërkombëtar është një hap i rëndësishëm në këtë drejtim dhe që ky çmim prestigjioz do të nxisë interes për librat e tij, mbase edhe për letërsinë shqiptare në përgjithësi.

[V.M.]: *Cila është axhenda juaj e përkthimeve në gjuhën angleze veçanërisht nga veprat e Kadaresë?*

[R.E.]: Unë vazhdoj të përkthej autorë të letërsisë shqiptare sipas kohës që kam në dispozicion dhe sipas qejfit. Shumë përkthime të mia janë botuar në vendet e ndryshme, por kam edhe shumë material të përkthyer dhe të shfaqur në faqen time të internetit: www.albanianliterature.net ku janë të pranishëm më shumë se 60 autorë shqiptarë, ndër atë është natyrisht edhe Ismail Kadare.

[V.M.]: *Kur keni nisur të përktheni veprat e Kadaresë?*

[R.E.]: Që në vitin 1993 botova një cikël poezish të Kadaresë në një antologji poetike në Angli. Kam përkthyer edhe romanin "Krushqit janë të ngrirë" i cili u botua në Amerikë në vitin 1997. Koha e fundit kam përkthyer edhe tri tregime të bukura të Kadaresë të cilat parashikohen të dalin në antologjinë e parë e tregimit shqiptar anglisht, "Balkan Beauty, Balkan Blood." Ky vëllim, i përgatitur nga unë, do të botohet nga Northwestern University Press në Çikago në janar të vitit 2006.

[V.M.]: *Si albanolog cilët nga përkthyesit në kohëra të ndryshme do të vlerësonit për përkthimet që kanë bërë nga shqipja në anglisht?*

[R.E.]: Sa e shoh unë, të gjitha botimet që kanë dalë në Angli apo në Amerikë kanë qenë shumë të mira. Një përjashtim duhet të bëhet mbase për vëllimet e hershme të Kadaresë të përkthyer dhe të botuara në Tiranë gjatë kohës së diktaturës komuniste, të cilat sipas meje nuk arrijnë nivelin e duhur, p.sh. “*Dasma*” anglisht 1968, dhe “*Kështjella*” anglisht 1970.

[V.M.]: *Po për përkthyesit e Kadaresë në këtë gjuhë ç'mendim keni, duke iu referuar sidomos këtu njërit prej tyre Arshi Pipës?*

[R.E.]: Kadareja ka disa përkthyes anglisht, apo të themi më mirë, ka disa persona, të paktën dhjetë veta, që janë marrë herë pas here me përkthimin e veprave të Kadaresë anglisht në Perëndim. Për fat të keq, deri tani nuk ka dalë anglisht një përkthyes profesionist, në kuptimin e një njeriu i cili e përkthen Kadarenë si angazhim kryesor dhe i cili jeton nga përkthimet e tilla, siç e disponon Kadareja për gjuhët e tjera: frëngjisht (Jusuf Vrioni, Tedi Papavrami), spanisht (Ramón Sánchez Lizarralde), gjermanisht (Joachim Röhm) dhe hollandisht (Roel Schuyt).

Lidhur me Arshi Pipën, sa e di unë, ai e kishte përkthyer “*Kronikën në gur*,” por duke qenë se anglishtja nuk ishte gjuha e tij amtare, përkthimi kishte dalë me të meta dhe shtëpisë botuese i është dashur të redaktojë përkthimin rrënjësisht. Në fund, libri kishte dalë pa e përmendur emrin e përkthyesit.

Nga përkthyesit e tjerë të Kadaresë janë Derek Coltman (“*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*,” anglisht 1971), Jon Rothschild (“*Kush e solli Doruntinën*,” anglisht 1988), Barbara Bray (“*Pallati i ëndrrave*,” anglisht 1993; “*Koncerti*,” anglisht 1994), dhe Emile Capouya (“*Nga një dhjetor në tjetrin*,” anglisht 1994), të cilët kanë përkthyer nga frëngjishtja. Përkthyesi më aktiv sot është David Bellos nga Universiteti i Princeton-it (“*Piramida*,” anglisht 1996; “*Dosje H*,” anglisht 1997; “*Lulet e ftohta të marsit*,” 2002; dhe “*Pasardhësi*,” anglisht 2006), i cili përkthen gjithashtu nga frëngjishtja. John Hodgson nga Londra ka përkthyer nga shqipja “*Prillin e thyer*,” anglisht 1990, dhe “*Urën me tri harqe*,” anglisht 1997, kurse Peter Constantine ka përkthyer “*Tri këngë zie për Kosovën*,” anglisht 2000. Koha e fundit, John Cox nga Universiteti i Virgjinisë Perëndimore ka përkthyer “*Brezninë e Hankonatëve*,” përkthim ky nga gjermanishtja, por nuk ka marrë autorizimin e botimit nga Fayardi ku, siç duket, ka mjaft ngatërresa. Nuk di pse. Është për t’u gëzuar që Zoti Kadare e ka nderuar David Bellos me çmimin e përkthimit duke qenë se ky i fundit vazhdon me përpjekjet e tij për të prezantuar shkrimtarin shqiptar botës anglishtfolëse.

Shpresoj se, pas akordimit të çmimit Man Booker Ndërkombëtar, do të dalin përkthime të tjera anglisht nga Bellos-i, mbase edhe nga të tjerët, sepse Kadareja është një autor i cili vlen të lexohet dhe i cili lexohet me shumë kënaqësi. Ky çmim është një shans i madh për Kadarenë edhe për letërsinë shqiptare.

E intervistoi Violeta Murati.

[botuar në gazetën *Metropol*, Tiranë, 15 qershor 2005 / published in the newspaper *Metropol*, Tirana, 15 June 2005.]